



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KRYETARI

5542
Nr. Prot

Roskovec, më 15.09. 2023

**SHPALLJE PËR VEND TË LIRË PUNE
PËR POZICIONIN**

**PSIKOLOG
PUNONJËS SOCIAL
KOORDINATOR PROJEKTI
TERAPIST OKUPACIONAL
MJEK-SPECIALIST NEUROZHILLIMI**

Në kuadër të projektit “Përmirësimi i shërbimeve dhe zhvillimit personal të personave me AK në territorin e Bashkisë Roskovec”, financuar nga UNDP-ja, programi “Leave no One Behind” (LNB2).

Bashkia Roskovec hap thirrjen për shprehje interesë për pozicionet e mëposhtme:

1. Psikolog
2. Punonjës Social
3. Koordinator projekti
4. Terapist okupacional
5. Mjek-Specialist neurozhvillimi

Më poshtë shpjegohen detyrat dhe kriteret për secilin pozicion.

1. PSIKOLOG - me kohë të plotë (1 pozicion)

Funkzionet kryesore të veprimtarisë së psikologut

Psikologu është një nga anëtarët më të rëndësishëm të ekipeve multidisiplinare. Ai është përgjegjës për shërbimet e ofruara në qendrat për zhvillim dhe integrim. Duke e konceptuar punën me individin si të pandarë nga rrjeti dhe komuniteti, fukcionet dhe detyrat e psikologut në qendër janë të lidhura ngushtë si më poshtë:

Vlerësime specifike të fushës

- Kryen teste inteligjencë për përcaktimin e koeficientit të inteligjencës
- Kryen teste të vizatimit për përdorues të veçantë

- Kryen teste vizualo-motore për vlerësimin e afësive të personave ne AK
- Bën teste psikologjike për persona me probleme të rënda emocionale

Psikologu dhe puna në ekip për vlerësimin dhe hartimin e programeve

- Diskuton me ekipin problemet e përdoruesit të shërbimit
- Ndan dhe diskuton me anëtarët e ekpit informacionin e nevojshëm
- Diskuton për problem psiko-emocionale, për probleme të sjelljes, si dhe qëndrimin që stafi duhet të mbaj ndaj tyre
- Diskuton mbi astësitë e përdoruesit në fusha të ndryshme.
- Jep mendimin në trajtimin e e problemeve të ndryshme emocionale (frikëra, xhelozira, etj).
- Diskuton mbi sjelljet jo tipike të personit si: ritualet, obsesionet, stereotipë apo çrregullimet e integritetit sensorial dhe qëndrimet ndaj tyre.
- Diskuton mbi pikat e forta të përdoruesit të shërbimit dhe stimulimin e tyre.
- Përcakton fushat e ndërhyrjes immediate.
- Merr pjesë në hartimin e raportit të vlerësimit të nevojave.
- Merr pjesë në hartimin e planit edukativ individual së bashku me ekipin multidisiplinar.
- Merr pjesë në rivlerësime.
- Jepmendime për ndërhyrjen me kujdestarin.
- Plotëson dokumentacionin individual të klientit për problemet e mësipërme dhe e mirëmban atë.

Ofron trajtimin terapeutik dhe psikoterapeutik për përdoruesit e shërbimit

- Ofron teknika të trajtimit terapeutik për përdoruesit në bazë të PEI në fushën e konjicionit, të problemeve psikoemocionale dhe problemeve të sjelljes.
- Kryen këshillim psikologjik
- Kryen mbështetje emocionale për përdorues që e kanë të nevojshme.
- Ndërhyr në situata të sjelljes ekstreme nga përdorues të ndryshëm.
- Jep teknika dhe terapi për modifikimin e sjelljeve jo të përshtatshme.

Roli i psikologut me familjen e përdoruesit të shërbimit

- Merr kontakte me kujdestarin dhe anëtarët e tjerë të familjes
- Analizon çdo marrëdhënie të personave me AK me anëtarët e tjerë të familjes
- Analizon marrëdhëni e anëtarëve ndërmjet tyre duke analizuar ndikimin e tyre te përdoruesi
- Vlerëson faktorë të tjerë familjar (abuzim, hiperproteksion, neglizhim) që mund të kenë ndikim në problemet e personave me AK
- Vlerëson gjendjen psikoemocionale të kujdestarit
- Udhëzon dhe informon kujdestarin për çdo problem të rëndësishëm të përdoruesit të shërbimit

- Planifikon dhe realizon ndërhyrjen psiko-edukative në familje
- Jep këshillime për kujdestarin me qëllim largimin e stresit, stigmës, etj.
- Jep mbështetje psiko-emocionale për të, duke krijuar grupe mbështetje me prindër me qëllim: lehtësimin e streseve, ndarje eksperiencash të përbashkëta , etj.

Kualifikimet kryesore të kërkua:

- Arsimi i lartë, Fakulteti i Shkencave Sociale, dega psikologji (specializuar për psikologji klinike);
- Njohuri të mira të kuadrit ligjor për cështjen e aftësisë së kufizuar;
- Të ketë eksperiencë pune;
- Njohuri të mira në programet kompjuterike;
- Aftësi të shkëlqyera në komunikim, ndërmjetësim dhe intervistik si dhe aftësi të provuara të punës në grup;
- Të ketë eksperiencë specifike në menaxhimin e rasteve;
- Njohuri/përvojë/trajnime mbi Terapinë e Sjelljes së Aplikuar, Terapinë e Zhvillimit dhe të Lojës (e preferueshme)
- Të jetë i komunikueshëm dhe i aftë të punoj në familje/terren

2. PUNONJËS SOCIAL – me kohë të plotë (1 pozicion)

Funksionet kryesore të veprimtarisë së punonjësit social

Punonjsi social në këtë vend pune është përgjegjës për dhënien e shërbimeve psiko-sociale përmes vleresimit të nevojave social-ekonomike, funksionimit dhe faktorëve riskues të fëmijes me aftësi të kufizuara dhe families së tij. Në bazë të këtij vlersimi ai mbështet fëmijën me aftësi të kufizuar dhe familjen e tij përmes aktiviteteve të tillë si: ndërmjetësimi, advokimi, koordinimi me institucionet dhe shërbimet, menaxhimi i dokumentacionit dhe dosjes së rastit, ngritjes së kapaciteteve të familjes dhe komunitetit në të cilin do të punojë. Ai do të punojë si pjesë e ekipeve te specialisteve në qendër dhe atij lëvizës si dhe me profesionistë të tjera në hartimin dhe zbatimin e planit individual të fëmijës si dhe ka rol kyç në hartimin dhe ndjekjen e planit të zhvillimit të familjes. Ai ka si përgjegjësi kryesore menaxhimin dhe koordinimin e te dy ekipeve, atij lëvizës dhe te qendrës si dhe bashkërendimin dhe koordinimin e punës së ekipeve me shërbimet/institucionet e tjera në komunitet.

Funksionet kryesore dhe detyrat specifike:

- Kryen vlerësime të nevojave psiko sociale dhe ekonomike të rastit.
- Kryen vlerësime të kapaciteteve, funksionimit dhe zhvillimit të rastit (që përfshijnë kërkesat për mbështetje dhe pjesëmarje, shtëpi dhe akomodim).
- Kryen vlerësime përmatjen e riskut (p.sh. të dhunës dhe abuzimit në familje).
- Mbështet familjen e personave me aftësi të kufizuar duke punuar direkt me familjen dhe persona të tjera të rendësishëm .

- Harton planin e zhvillimit personal të personave me AK në bashkëpunim me ekipet dhe profesionistë të tjerë.
- Harton planin e zhvillimit të familjes në bashkëpunim me ekipet dhe profesionistë të tjerë.
- Ndihamon në krijimin dhe mirëmbajtjen e dosjes personale te personave me AK duke grumbulluar informacionin e duhur për ekuilibrin psikosocial.
- Punonjësi social implementon programe të planit të kujdesit si:
 1. Menaxhimin e sjelljeve të papranueshme.
 2. Rritjen e kapaciteteve informative në fusha të ndryshme.
 3. Organizon dhe drejton tema sociale të rendësishme për këtë target grup.
 4. Ndihamon personat me AK të eksplorojnë interesat e tyre, të zhvillojnë talentet dhe pavarësinë, të rrisin vetëvlerësimin dhe te mësojnë si të sillen me të tjerët në situata te ndryshme.
- Organizon dhe menaxhon aktivitete argëtuese që nxisin zhvillimin fizik, emocional, intelektual dhe social të PAK, si brenda institucionit dhe jashtë tij.
- Punon në komunitet për të sensibilizuar opinionin publik për nevojat e personave me AK.
- Krijon rrjetin mbështetës për PAK në komunitet duke vendosur marrëdhënie mes ekipit lëvizës, atij në qendër, kopshteve, shkollave, qendrave shëndetësore, njësisë administrative, bashkisë dhe shërbimit social shtetëror.
- Harton planin e zhvillimit të familjes sëbashku me ekipet dhe profesionistë të tjerë.
- Ben menaxhimin e rastit dhe koordinimin e shërbimit ne përputhje me kriteret dhe kërkesat ligjore. Kryen shërbime ndërmjetësimi e referon fëmijën/familjen në shërbime të tjera.
- Mban dhe menaxhon dokumentacionin dhe dosjen e rastit.
- Jep mbështetje në koordinim dhe bashkërendim të punës së ekipit lëvizës dhe ekipit të qendrës.
- Jep ndihmë në çë shtjet e strehimit, ndihmë ekonomike dhe çë shtje të tjera të ngjashme në dobi të familjes së fëmijës me aftësi të kufizuara.
- Advokon për personat me AK dhe familjen. Mbështet individët të jenë vetë advokues ose advokon në emër të tyre.
- Ngre kapacitetet përmes përfshirjes, edukimit dhe konsultimit me grupet lokale në komunitet, rrjetet, bizneset dhe qeverisjen lokale për të zhvilluar komunitete me përfshirëse për personat me aftësi të kufizuara duke hequr barrierat që pengojnë aksesin fizik dhe social.
- Ngre kapacitetet përmes punës me shërbimet në komunitet duke rritur ndërgjegjësimin, të kuptuarin dhe dijen për çështje të aftësisë së kufizuara dhe familjeve të tyre në mënyre që shërbimet e përshtatshme dhe efektive të jepen në kohë.
- Ngre kapacitetet e individëve dhe familjeve për të naviguar në sistemet shëndetësore dhe të mirëqenies apo akses në informacion.
- Formulon deklarata/raporte të nevojave dhe e ndan këtë informacion me persona të përshtatshëm (agjensi, institucione, qendra, grupe multidisiplinare).

Kualifikimet kryesore të kërkuar

- Diplomë e nivelit master në degën e punës sociale.
- Të ketë eksperiencë në profesion (prioritet përvojë në shërbimet sociale për aftësinë e kufizuar).
- Të ketë njohuri bazë për të kuptuar dhe ndjekur procedura dhe procese të shërbimeve sociale.
- Te ketë aftësitë e mira për të shkruar raporte.
- Gëzon integritet individual dhe profesional si dhe pjekuri emocionale
- Aftësi të mira planifikuese dhe organizative, negociuuese dhe në zgjidhjen e konfliktit
- Aftësi të mira interpersonale dhe i aftë të punojë me grupe të ndryshme në mënyrë profesionale dhe etike.
- Të respektojë të drejtat themelore, dinjitetin e fëmijës dhe familjes.
- Ka pasion për punën dhe ndihmën ndaj njeriut
- Njohuri/përvoje/trajnime mbi Terapinë e sjelljes së Aplikuar, Terapinë e Zhvillimit dhe të Lojës (e preferueshme).
- Të jetë i komunikueshëm dhe i aftë të punoj në familje/terren
-

3. **KOORDINATOR PROJEKTI - me kohë të pjesshme (1 pozicion)**

Funkzionet kryesore të veprimtarisë së koodinatorit te projektit.

Koordinatori I projektit ne këtë vend punë është përgjegjës për koordinimin e ecurisë së projektit dhe mban gjithmonë konktaktë me personat të tjerë që janë të përfshire në project.

Funkzionet kryesore dhe detyrat specifike:

- Të identifikojë personat me AK.
- Të ofrojë konsulencë dhe mbështetje për familjet që kanë në gjirin e tyre persona me aftësi të kufizuara
- Të bashkëpunojë me institucionet lokale,Bashkinë e Roskovecit,qendrën PAK dhe qendrë n shëndetësore dhe palë t e tjera të përfshire në implemetimin e projektit ,me qëllim arritjen e objektivave specifike të projektit.
- Të sigurojë dokumentacionin e kërkuar mbi përfituesit dhe të përgatisë një raport final mbi ditët informuese\ndërgjegjësuese.
- Të raportojë cdo muaj tek menaxherja e projektit.
- Duhet të sigurohet se cdo raportim të jetë në përputhje me procedurat dhe në kohën e kërkuar nga donatori.

- Të organizojë takime ndërmjet palëve, axhendat e takimit, minutat e takimeve dhe aktiviteteve

Kualifikimet kryesore të kërkuara

- Arsim i lartë pasuniversita ose bachelor,
- Të ketë eksperiencë me projekte.
- Të ketë aftësi të mira kompjuterike.
- Të ketë aftësi të mira për të shkruar raporte pune.
- Aftësi të mira planifikuese dhe organizative, negociuese në zgjidhjen e konfliktit
- Aftësi të mira komunikimin dhe bashkëpunimi me grupin e punës.
- Të jetë i komunikueshëm dhe i aftë të punoj në familje/terren

4 . TERAPISTI OKUPACIONAL – ekspert me kohë të pjesshme (1 pozicion)

Funksionet kryesore të veprimtarisë së Terapistit Okupacional

Terapisti okupacional kryen procedura dhe zbaton metoda trajnimi aktive për të përshtatur klientët për aktivitetet e jetës së përditëshme, sa më të pavarur, për aktivitete kreative dhe socio-kulturale, nëpërmjet teknikave artizanale dhe profesionale. Terapsiti okupacional është një profesionist para-mjekSOR që shoqëron personat me disfunksion fizik, psiqik ose social, duke u përpjekur për t'i siguruar ose ruajtur atyre një funksion sa më optimal në jetën e tyre të përditëshme, nëpërmjet përdorimit të aktiviteteve konkrete duke marrë parasysh potencialin dhe pengesat e mjedisit ku ata jetojnë. Terapsitët e punës ofrojnë shërbime rehabilituese për personat me aftësi të kufizuar mendore, fizike, emotive ose shërbime rehabilituese për personat me aftësi të kufizuar mendore, fizike, emotive ose shërbime për probleme të zhvillimit

Funksionet kryesore dhe detyrat specifike:

- Merr informacion të detajuar nga familjari për funksionimin e klientit në familje.
- Observon klientin, mënyrën sesi funksionon në familje, si kryen detyrat personale, sa dhe si përfshihen në detyrat e familjes.
- Si e kalon kohën e lirë dhe çfarë preferencash ka.
- Observon nëse klienti ka nevojë për mjete përshtatëse ndihmëse gjatë kryerjes së veprimeve rutinë.
- Terapisti okupacional bashkëpunon me ekipin multidisiplinar të qendrës.
- Përcakton objektivat rehabilituese për planin edukativ.
- Bashkëpunon me fizioterapistë, ortopedistë për mjetet ndihmëse ose përshtatshmëri të ndryshme në qendër dhe familje.

- Bashkëpunon me psikologun, punonjësin social për trajnime të ndryshme përshtatur me aftësitë, prirjet dhe dëshirat e klientit për të kryer punë të thjeshta me pak mbështetje.
- Trajnon përdoruesin për kryerjen e detyrave të ndryshme në qendër duke filluar nga ato më të thjeshtat deri te detyrat në guzhinë, gatim, mirëmbajtje mjedisi, etj.
- Punon në mënyrë të vazduar për të rritur vetëvlerësimin e klientëve nëpërmjet mbështetjes dhe përforcimit me mënyra të ndryshme.
- Përcakton llojin e aktivitetit artisanal që do të trajnohen (punë me lesh, me dru, me rruaza, me shtiza, me qylyma, me baltë, ne guzhinë, në kopshtari, etj.).

Kualifikimet kryesore të kërkua

- Arsimi i lartë, të preferueshëm: Pedagogja Speciale/ Fizioterapia
- Njohuri të mira të kuadrit ligjor per personat me aftësi të kufizuara;
- Të ketë eksperiençë pune;
- Njohuri të mira ne programet kompjuterike;
- Aftësi të shkëlqyera në komunikim, ndërmjetësim dhe intervistim si dhe aftësi të provuara të punës në grup;
- Njohuri/përvojë/trajnime mbi terapinë e sjelljes së aplikur, terapinë e zhvillimit dhe të lojës (e preferueshme)
- Të jetë i komunikueshëm dhe i aftë të punoj në familje/terren.

5. MJEK SPECIALIST NEUROZHILLIMI – ekspert me kohë të pjesshme (1 pozicion)

Funksionet kryesore të veprimtarisë së mjekut specialist neurozhvillimor.

Mjeku specialist neurozhvillimor në këtë vemd punë është përgjegjës për trajtimin e personave me AK dhe të krijojë dosje personale individuale sipas diagnozës përkatëse.

Funksionet kryesore dhe detyrat specifike :

- Të rrisë aftësitë motorike të personave me AK.
- Rifitimin e funksionalitetit normal të personave me AK përmes edukimit të lëvizjeve.
- Të kontrollojë funksionet jetësore të nën-vetëdijes.
- Të testoje statusin mendor dhe funksionet trupore të personave me AK.
- Shqyrton pamjen e personave për praninë e asimetrisë së fytyrës dhe trupit.
- Të ekzaminojë reflekset.
- Të kontrollojë ndjeshmërinë trupore të personave me AK.

Kualifikimet kryesore të kërkua

- Arsimi i lartë, neurolog/psikiatër

- Njohuri të mira të kuadrit ligjor per personat me aftësi të kufizuara;
- Të ketë eksperiençë pune;
- Njohuri të mira ne programet kompjuterike;
- Aftësi të shkëlqyera në komunikim, ndërmjetësim dhe intervistim si dhe aftësi të provuara të punës në grup;
- Të jetë i komunikueshëm dhe i aftë të punoj në familje/terren

Kohëzgjata e projektit : 17 muaj

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidati duhet të dërgoje me E-mail në adresën : info@bashkiaroskovec.gov.al

Me postë ose dorazi në Qendrën Social Komunitare, dokumentet e dosjes së tij personale si më poshtë :

- Letër motivimi për aplikim në pozicioni që po aplikon
- CV
- Fotokopje e diplomës.
- Fotokopje e listës së notave.
- Fotokopje e librezës së punës;
- Fotokopje e kartës së identitetit;
- Dëshmi penaliteti
- Çertikata të ndryshme trajnimesh, kualifikimet e tjera, etj.. (nese ka)

Afati I dorëzimeve të dokumentacioneve nga aplikantët është deri në datën 24/09./2023

K R Y E T A R

Majlinda Buçi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZËVENDËSKRYETARI

Maksim Gega

